



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prave - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelaria Ministra Prave - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 220 / 2025

Datë: 14 / 04 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 10 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin Nr. 08/L-272, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministrija në Detyrë e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Vlora (Adnan) Osmani, emërohet në detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Prishtinës.
2. Në pajtim me nenin 20 (paragrafi 1 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, obligohet e emëruara që brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i ofrojë Ministrisë së Drejtësisë dëshminë përkatëse me të cilin vërteton dorëheqjen e saj nga funksioni aktual zyrtar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas propozimit të Komisionit për Zgjedhjen e Noterëve për kandidatët që i plotësojnë kushtet për të ushtruar funksionin dhe shërbimin noterial në Republikën e Kosovës, si dhe duke pasur për bazë legjislacionin përkatës në fuqi për noterinë që rregullon këtë çështje, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albulena HAXHIU
Ministre në Detyrë e Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Vendimi i'u dërgohet:

- *Të emëruarës Znj. Vlora Osmani;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Politika Sistemit Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*